**VENDIM**
**Nr.818, datë 29.11.2007**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS GOLEM TË QARKUT TË FIERIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Golem të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 50 (pesëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 256 (dyqind e pesëdhjetë e gjashtë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna e Golemit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

Komuna Golem
Lidhja 1

| Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit | Fusha e përdorimit të pronës | Lloji i transferimit |
|---|---|---|
| 1,2 | Monumente historike e kulturore dhe buste me interesa vendore | Në pronësi |
| 3-7 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive | Në pronësi |
| 8-16 | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore | Në pronësi |
| 17-22 | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik | Në pronësi |
| 41-68,204-205,243,244,245,246,250,252,253 | Troje të lira dhe hapësira të pazëna ndërmjet objekteve dhe ndërtesave të çdo lloji | Në përdorim |
| 69-79 | Varrezat publike | Në pronësi |
| 87-103 | Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile | Në pronësi |

| | | |
|---|---|---|
| 23-40,106,108-129,247,248,249,251 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik | Në pronësi |
| 134,163,169,182 | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit, kanale të treta dhe tokë jobujqësore | Në pronësi |
| 136-153 | Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit tokë bujqësore | Në përdorim |
| 183-193,254-256 | Ujësjellësa të veçantë të fshatrave.Kanalizime të veçanta të fshatrave | Në pronësi |
| 194-203,206,207,209-210 | Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe shërbime publike | Në pronësi |
| 204-241 | Rrjeti i ndriçimit publik | Në pronësi |